



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr.589, datë 18.10.2023**

**PËR**

**RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 19, DATË 18.01.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 18.10.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Alban Toro,

**VËREN:**

**I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES**

1. Me disa vendimet e datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (*më poshtë referuar si Këshilli*) hapi katërbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 19, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.02.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 19 datë 18.01.2023 (*më poshtë referuar si vendimi 19/2023*), kandiduan gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë, sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Pozicioni</b>	<b>Nr</b>	<b>Vendimi nr. 19</b>
1		{...}
2		{...}
3		{...}
4		{...}
5		{...}
6		{...}
7		{...}
8		{...}
9		{...}
10		{...}
11		{...}

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedura në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 19/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë janë përfshirë 2(dy) kandidatë sipas vendimit respektive:

<b>Pozicioni</b>	<b>Nr</b>	<b>Vendimi nr. 19</b>
1		{...}
2		{...}

5. Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Tiranë, të shpallura me vendimet nr. ...; 19;..datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat.

6. Për z. Gentjan Marku, Këshillit me vendimin nr.383, datë 17.07.2023 ka vendosur: “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, nr.19 dhe nr. 20 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”

6.1 Gjatë vijimit të procedurave z. Gentjan Marku u tërhoq nga kandidimi i tij për këtë pozicion të lirë, dhe Këshillit me vendimin nr. 331, datë 21.06.2023ka vendosur: “...Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për

*pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, për kandidatën z. Gentjan Marku , për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion...”*

7. Për Znj. Diamela Goxha Këshilli me vendimin nr.278 datë 25.05.2023 ka vendosur: “...Për deklarinimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. Diamela Goxha, për shkak të transferimit të kandidatës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 të Këshillit...”

8. Në vijim ndjekjes së procedurave për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë kandidatët z, Gjergji Baçi, znj. {...}, kandidatë që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, referuar vendimin nr.77, datë 13.02.2023, (shtojca nr. III) si dhe znj. Suela Xhani dhe z. Ardit Kuka kandidatë që kanë dhe mund të kenë një vlerësim, referuar vendimin nr.77, datë 13.02.2023, (shtojca nr. II) u tërhoqën nga kandidimi i tyre për këtë pozicion të lirë. Për këta kandidatë Këshilli nuk ka marrë asnjë vendimmarrje lidhur me tërheqjen e tyre pasi procedura për fillimin e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore nuk kishte nisur.

9. Në pozicionin nr. 19 datë 18.01.2023 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2(dy) vlerësime vlerësim. Në këto rrethana Këshilli, në zbatim të pikës 49 të vendimit 320/2020 , me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.”

<b>Pozicioni</b>	<b>Nr</b>	<b>Vendimi nr. 19</b>
1		{...}
2		{...}

10. Për z. Ervin Sulaj, Këshillit me vendimin nr.449, datë 24.07.2023 ka vendosur: “Për kualifikimin e kandidatit Ervin Sulaj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”

10.1 Gjatë vijimit të procedurave z. Ervin Sulaj u tërhoq nga kandidimi i tij për këtë pozicion të lirë, dhe Këshillit me vendimin nr. 517, datë 05.10.2023 ka vendosur: “...Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, për kandidatën z. Ervin Sulaj , për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion...”

11. Për Znj. Ina Hoxhaj Këshilli me vendimin nr.521 datë 05.10.2023 ka vendosur: “...Për kualifikimin e znj Ina Hoxhaj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”...”

12. Sipas pikës 7, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë lëvizje paralele për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të transferohet nëpërmjet mekanizmit të lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në atë pozicion të lirë.

13. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga i vetmi kandidat të kriterëve të më poshtme:

- 1) **“përvojës profesionale minimale”**, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ose nëse ka në fuqi një masë disiplinore”;
- 2) **“mospasjes masë disiplinore në fuqi”**, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se .... ose nëse ka në fuqi një masë disiplinore”;
- 3) **“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”**, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efikasiteti dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... transferim, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”;

14. Kështu, për kandidaten e vetme, znj. Ina Hoxhaj, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi

plotësimin nga ajo të kritereve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 521, datë 05.10.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin, nr.19 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

15. Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kritereve të kandidimit, për këtë kandidatë ishte përfunduar dhe procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2018-2020, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

16. Këshilli, me Vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, kishte vendosur fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 19, datë 18.01.2023. (kur në këtë pozicion ishin të kualifikuar kandidatët me dy vlerësime). Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Alban Toro. Me kualifikimin e kandidatës znj. Ina Hoxhaj, bazuar në pikën 75 Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 19.02.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, (më poshtë referuar si Vendimi 320/2020), më datë 06.10.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 e vijuese të Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidatja e kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatja nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

17. Në zbatim të pikës 106, të Vendimit të Këshillit 320/2020, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për kandidaten e kualifikuar, që gjendej në dosjet e saj personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimin të kritereve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar: i) vendimin përkatës të Këshillit në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional për kandidaten e kualifikuar; ii) certifikatat e vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës për kandidaten, si edhe listën e Klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për kandidatët e diplomuar në Qershor 2015.

17.1 Konkretisht, lidhur me vlerësimet e Shkollës së Magjistraturës, për kandidaten u konstatua se: Kandidatja znj. Ina Hoxhaj e diplomuar në vitin akademik 2012-2015 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2012 qershor 2015) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4428.13 pikësh..

17.2 Konkretisht, lidhur me vlerësimin etik dhe profesional, për kandidaten e vetme znj. Ina Hoxhaj u konstatua se:

- a) Sipas Vendimit të Këshillit nr.7 datë 18.01.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2018-2020 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”, duke grumbulluar në total 395 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

18. Vlerësimi etik dhe profesional i kandidatës z. Ina Hoxhaj i miratuara me Vendimin e Këshillit nr.7 datë 18.01.2023, u konstatua të jetë bërë përfundimtar, ndërsa ndaj tij nuk është paraqitur ankim.

19. Kandidatja e vetme e renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 19, datë 18.01.2023, pra znj. Ina Hoxhaj pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që, në momentin e kandidimit, të mos ketë shprehur preferenca kandidimi sikurse përcaktohet në pikën 5, të nenit 43, të Ligjit për Statusin. Për pasojë, për këtë kandidatë është e pazbatueshme preferenca e kandidimit, duke u konsideruar njësoj të preferuar për të, çdo kandidim i saj.

20. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm një kandidatë dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një e tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni C të Vendimit 320/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit D, Kreu VI, të Vendimit 320/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

21. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 19 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Seksionin DH, Kreu VI, të Vendimit 320/2020.

22. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidatet në funksion të renditjes, përveç edhe korrektësinë e projektvendimit.

## **III. KONKLUZIONI**

23. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 19 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

## **PËR KËTO ARSYE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”,

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
  1. Znj. Ina Hoxhaj.
  2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. Ina Hoxhaj sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**